



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.280/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret; Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;03.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.280/2025 e datës;31.01.2025, dhe Anr.284/2025, të datës;01.02.2025.

II. Subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro

III. Detyrohet Subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë;31.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë;30.01.2025 në një postim në rrjetin social në facebook të Smajl Lushtakut-mbështetës i PDK-së, është publikuar një tekst i cili përmban gjuhë të urrejtjes dhe ofendeuese i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së. Parashtruesi i ankesës thekson se tekstin në facebook është si në vijim: *“Të ngrehet simboli çetnik me tre gishta në zemër të Drenicës, ose duhet të jeshë i çmendur ose çetni!, Pas 25 viteve në liri vijnë lahperat nga Prishtina të kulmisur në LVV me seli në Prishtinë-Beograd dhe Athinë, në zemër të Drenicës –Skenderaj ngrehin (tre gishtërinj) në emër (të jatit-birit dhe shpirtit të shenjte)! Deri kur do ti tolerojmë këta idiot që fshehën pas petkut partiak dhe politik, Drenica gjithnjë e ka pase tradite për mikun (bukë e krip me zemer) për armikun plumb ballit sepse farën e birzumë në Shumadi vetëm plumbi e skuqe”*. I njëjti në postimin e tij thekson se *“ta provokosh Drenicen gjakun e derdhur rr’ke nga viti 1389, kjo është antinjerzore dhe bizare! Kush! Bijte e kurvave nga Prishtina! Me demagogun dhe gënjeshtarin me të madh të shek. XXI (Kurcin)”*. I njëjti në postimin e tij thekson: *“se herën tjetër a po i presim me lule dhe tepih të kuq apo me batore dhe hanxhar”*. Për më tepër i njëjti thekson se *“ata vijnë nga Prishtina me porosi të Beogradit dhe ngrehin tre gishta nuk ka me as toleranc as hyrje në Drenice dhe kërkon nga strukturat e komunale të Skenderajt që subjekti politik LVV-ne ta shpallin non grata dhe ate zyre me tr apo katër shulikuranta ta mbyllin, dhe kushe të doje nga Drenica le të veje në Prishtinë apo Beograd të zhvillojë aktivitetet”*.

Po ashtu më datë;01.02.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë;01.02.2025 në një postim në rrjetin social në facebook të Rasim Brahim Rexhepi-mbështetës i PDK-së, është publikuar një tekst i cili përmban gjuhë të urrejtjes dhe ofendeuese i cili bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së. Parashtruesi i ankesës thekson se tekstin në facebook është si në vijim: *“Mirmëngjesi populli i Albin mashtruesit që nuk ja ka pranuar e njoft grua shtetin e Kosovës tash nuk e ka as të drejtën e votës a ju e keni ngul në krye të Qeverisë një kryeministër që nuk ja njeh grua e fmija shtetin çka i duhet kti vëndi, vlerësone vet, dikush e ka jep krejt mundin jetën edhe familjen për këtë shtet e kryeministrit nuk ja njeh grua shtetin”*. Parashtruesi i ankesës thekson se Besim Brahim Rexhepi është konfirmuar si mbështetës i PDK-se dhe është ndëshkuar me vendimin e PZAP-it A.nr.240/2025, për një shkelje tjetër.

Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime është shkelur neni me nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, e LZP-së, me të cilën përcaktohet se *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë, kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatet e tyre, përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Si provë që dëshmon shkeljen e pretenduar ka bashkangjitur postimet në rrjetet sociale facebook dhe linçet për shkeljen e tyre:

<https://ëëë.facebook.com/dona.lushtaku.33/posts/t%C3%AB-ngrehet-simboli-%C3%A7etnik-me-tre-gishta-n%C3%AB-zem%C3%ABr-t%C3%AB-drenic%C3%ABs-ose-duhet-t%C3%AB-jesh%C3%AB-/1131832268322011/>

https://ëëë.facebook.com/story.php?story_fbid=28774952262119056&id=100000929965027&rdid=folUKIUdGalaP9DJ#

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK më datë;02.02.2025, ka theksuar se pala ankuese nuk ka arritur që ta argumentojë përgjegjësinë subjektive ndaj subjektit politik PDK, dhe se ankuesi me asnjë provë nuk ka arritur që të bëjë ndërlidhjen e veprimeve të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë ngjarje me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, mirëpo të njëjtit janë mjaftuar vetëm me pretendimin se të njëjtit janë simpatizant dhe aktivist të PDK-së. Për më tepër PDK ka rënë në kontakt me personin Rasim Brahim Rexhepi, i cili e ka mohuar që këto veprime të kenë kryer për të fuqizuar dhe në emër të PDK-së, mirëpo këto statuse i publikon në shenjë revolte ndaj subjektit politik LVV, dhe se këto nuk nderlidhen fare me përfitimin e votave. Po ashtu subjekti politik PDK ka kontaktuar me Smajl Lushtakun për të shprehur shqetësimet në lidhje me shkrimet e tij në rrjetet sociale facebook ku i njëjti është përgjigjur se këto shkrime i ka bërë si qytetar i Drenices, dhe nuk janë bërë udhëzime apo direktiva nga PDK-ja, dhe se të njëjtin postim e ka fshirë dhe ka marrë masa permisuese për fshirjen e postimit në fjalë, dhe e njëjta propozon që ankesat të refuzohen të pa bazuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosi së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.280/2025, e datës;31.01.2025, dhe Anr.284/2025, të datës;01.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.280/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve

të parashtruara nga subjekti politik LVV, kundër subjektit të njëjtë politik PDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura nga ankesat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se ankesat janë të bazuara.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se Smajl Lushtaku mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar, *“Të ngrehet simboli çetnik me tre gishta në zemër të Drenicës, ose duhet të jeshë i çmendur ose çetnik, Pas 25 viteve në liri vijnë laperat nga Prishtina të kulmisur në LVV me seli në Prishtinë-Beograd dhe Athinë, në zemër të Drenicës –Skenderaj ngrehin tre gishtërinj ne emër te jatit-birit dhe shpirtit te shenjte. Deri kur do ti tolerojmë këta idiot qe fshehën pas petkut partiak dhe politik, Drenica gjithnjë e ka pase tradite per mikun (buk e krip me zemer) per armikun plumb ballit sepse farën e birzumë në Shumadi vetëm plumbi e skuqë”. “Ta provokosh Drenicen gjakun e derdhur nga viti 1389 kjo eshte antinjerzore dhe bizare! Kush! Bijte e kurvave nga Prishtina! Me demagogun dhe gënjeshtarin me te madh te shek. XXI Kurcin”. Po ashtu ka theksuar se “se herën tjetër a po i presim me lule dhe tepih te kuq apo me batore dhe hanxhar”. Gjithashtu ka theksuar se “ata vijnë nga Prishtina me porosi te Beogradit dhe ngrehin tre gishta nuk ka me as toleranc as hyrje ne Drenice dhe kërkon nga strukturat e komunale te Skenderajt qe subjekti politik LVV-ne ta shpallin non grata dhe ate zyre me tre apo katër shulikuranta ta mbyllin, dhe kushe te doje nga Drenica le te veje ne Prishtine apo Beograd te zhvilloj aktivitetet...”*.

Po ashtu Paneli, ka vlerësuar edhe shkresat e lëndës të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se Rasim Brahim Rexhepi mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar *“Mirmëngjesi populli i Albin mashtruesit që nuk ja ka pranë e njoft gruaja shtetin e Kosovës tash nuk e ka as të drejtën e votës a ju e keni ngul në krye të Qeveris një kryeministër që nuk ja njeh gruaja e fmija shtetin çka i duhet kti vëndi, vlerësone vet, dikush e ka jep krejt mundin jetën edhe familjen për këtë shtet e kryeministrit nuk ja njeh gruaja shtetin!”*.

Sipas Panelit vendosja përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të PDK-së, Smajl Lushtaku dhe Rasim Brahim Rexhepi, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimet e marra në kohë të fushatës zgjedhore kanë për qëllim të krijojnë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijojnë atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke përdorur gjuhë fyese, denigruese dhe përqueme kundër subjektit politik ankues dhe udhëheqësit të saj, dhe se ky veprim shihet si një mënyrë për të përdorur kualifikime të rënda për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt subjekti ankues. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose*

pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Me nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, është përcaktuar se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet “*të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro.*”

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm i subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Andaj Paneli vëren se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të mbështësve të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politik në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë. Po ashtu në rastin e caktimit të lartësisë së gjobës së shqiptuar Paneli mori parasysh edhe faktin se kandidati i PDK-së për kryeministër z.Bedri Hamza, iu ka bërë thirrje simpatizantëve të PDK-së, që të kënë kujdes në deklaratimet e tyre publike gjatë fushatës zgjedhore.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se subjekti politik PDK të njëjtat pretendime nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, kurse provat e prezentuar nga pala ankuese, përkatësisht, fotografia e bashakangjitur ankesës, vërtetohet fakti se Smajl Lushtaku është simpatizant i PDK-së. Gjithashtu edhe me vendimin e PZAP-së nr.240/2025, të datës;30.01.2025, është dënuar dënuar PDK me gjobë, për veprimet e mbwshtwtwsit, Rasim Brahim Regjepi, provë kjo që vërteton faktin se i njëjti është mbështetës i PDK-së.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.280/2025, datë;03.02.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.39/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Rustem Thaqi dhe Delushe Halimi, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës të Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.280/25 të datës 03.02.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht e themeltë ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dhe NDRYSHOHET pjesërisht vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.280/25 i datës 03.02.2025, dhe gjykohet ashtu që: Aprovohet ankesa e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, A.nr.280/2025 e datës 31.01.2025 dhe VENDOSËT që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, t'i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 8,000 €.

II. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.284/2025 e datës 01.02.2025, e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.



A r s y e t i m

Me pjesën e I të dispozitivit të vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr. 280/2025 dt.3.02.2025, pranohen si të bazuara ankesat e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, A.nr.280/2025 dt.31.01.2025 dhe A.nr.284/2025 dt.1.02.2025. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 15.000- euro. Me pjesën e III të dispozitivit, detyrohet Subjekti Politik PDK,, që gjobën si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

Kundër vendimit të sipër përmendur të PZAP-së, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, me kohë ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, nëpërmjet të cilës e kundërshton ligjshmërinë e vendimit të lartë cekur të PZAP-së, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet vendimi i PZAP-së A.nr.280/2025 dt.3.02.2025 dhe të refuzohen si të pabazuara ankesat A.nr.280/2025 dhe A.nr.284/2025, të ankuesit LVV pasi që nuk është arritur të argumentohet përgjegjësia subjektive e PDK-së.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, përmes të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Ankesa e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se PZAP, më datë 31.01.2025 dhe 01.02.2025 ka pranuar dy ankesa nga Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilat ka kërkuar që subjekti politik PDK, të gjobitet për shkak të shkeljeve të kodit të mirësjelljes.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), më datë 02.02.2025, me anë të së cilës i ka kundërshtuar në tërësi ankesat e subjektit politik LVV.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), PZAP-i, ka nxjerr vendimin A.nr.280/25 të datës 03.02.2025, me të cilën i ka aprovuar ankesat e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.



PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.280/2025, e datës 31.01.2025, dhe Anr.284/2025, të datës 01.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.280/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti politik LVV, kundër subjektit të njëjtë politik PDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura nga ankesat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, ka gjetur se ankesat janë të bazuara. Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se Smajl Lushtaku mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar, "Te ngrehet simboli çetnik me tre gishta në zemër të Drenicës, ose duhet të jeshë i çmendur ose çetnik, Pas 25 viteve në liri vijnë lahperat nga Prishtina të kulmisur në LVV me seli në Prishtinë-Beograd dhe Athinë, në zemër të Drenicës -Skenderaj ngrehin tre gishtërinj ne emer te jatit-birit dhe shpirtit te shenjte. Deri kur do ti tolerojmë këta idiot qe fshehen pas petkut partiak dhe politik, Drenica gjithnjë e ka pase tradite per mikun (buk e krip me zemer) per armikun plumb ballit sepse farën e birzumë në Shumadi vetëm plumbi e skuqe". "Ta provokosh Drenicen gjakun e derdhur nga viti 1389 kjo eshte antinjerzore dhe bizare! Kush! Bijte e kurvave nga Prishtina! Me demagogun dhe genjeshtarin me te madh te shek. XXI Kurcin". Po ashtu ka theksuar se "se herën tjetër a po i presim me lule dhe tepih te kuq apo me batore dhe hanxhar". Gjithashtu ka theksuar se "ata vijnë nga Prishtina me porosi te Beogradit dhe ngrehin tre gishta nuk ka me as toleranc as hyrje ne Drenice dhe kërkon nga strukturat e komunale te Skenderajt qe subjekti politik LVV-ne ta shpallin non grata dhe ate zyre me tre apo katër shulikuranta ta mbyllin, dhe kushe te doje nga Drenica le te veje ne Prishtine apo Beograd te zhvilloj aktivitetet...". Po ashtu Paneli, ka vlerësuar edhe shkresat e lëndës të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se Rasim Brahim Rexhepi mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar "Mirëmëngjesi populli i Albin mashtuesit që nuk ja ka pranë e njoft gruaja shtetin e Kosovës tash nuk e ka as të drejtën e votës a ju e keni ngul në krye të Qeveris një kryeministër që nuk ja njeh gruaja e fmija shtetin çka i duhet kti vëndi, vlerësone vet, dikush e ka jep krejt mundin jetën edhe familjen për kët shtet e kryeministri nuk ja



njuh gruaja shtetin!". Sipas Panelit vendosja përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të PDK-së, Smajl Lushtaku dhe Rasim Brahim Rexhepi, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, nga se veprimet e marra në kohë të fushatës zgjedhore kanë për qëllim të krijojnë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijojnë atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke përdorur gjuhë fyese, denigruese dhe përçmuese kundër subjektit politik ankues dhe udhëheqësit të saj, dhe se ky veprim shihet si një mënyrë për të përdorur kualifikime të rënda për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt subjektit ankues. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 pika 1.11), e LZP-se, me të cilën përcaktohet "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë Kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Me nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, është përcaktuar se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-s, mundet "të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro." Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes



për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm i subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë, i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve Zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Andaj, Paneli vëren se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të mbështësve të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politik në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje Paneli ka shqiptuar dënime me gjobë. Po ashtu, në rastin e caktimit të lartësisë së gjobës së shqiptuar Paneli mori parasysh edhe faktin se kandidati i PDK-së për kryeministër z. Bedri Hamza, iu ka bërë thirrje simpatizantëve të PDK-së, që të kenë kujdes në deklaratimet e tyre publike gjatë fushatës zgjedhore. Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se subjekti politik PDK të njëjtat pretendime nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, kurse provat e prezantuara nga pala ankuese, përkatësisht, fotografia e bashkangjitur ankesës, vërtetohet fakti se Smajl Lushtaku është simpatizant i PDK-së. Gjithashtu edhe me vendimin e PZAP-së nr.240/2025, të datës 30.01.2025, është dënuar PDK me gjobë, për veprimet e mbështetësit, Rasim Brahim Rexhepi, provë kjo që vërteton faktin se i njëjti është mbështetës i PDK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes vlerëson se PZAP, nuk ka bërë shekeje të dispozitave të procedurës me rastin e vendosjes për gjobën ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe vendimi mbi dënimin me gjobë është përfshirë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, me referencë në dispozitat e nenit 120 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon në tërësi gjendjen faktike të konstatuar nga PZAP, sa i përket ankesës A.nr.280/2025 të datës 31.01.2025, pasi që me provat që gjenden në shkresat e



lëndës konstatohet në mënyrë të plotë dhe të besueshëm gjendja faktike e konstatuar nga PZAP. Nga provat në shkresat e lëndës, por edhe nga përgjigjja në ankesë e dorëzuar tek Paneli, dhe me ankesën e paraqitur në Gjykatën Supreme, nga vet subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) konstatohet se Smajl Lushtaku mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar, “Te ngrehet simboli çetnik me tre gishta në zemër të Drenicës, ose duhet të jesh i çmendur ose çetnik, pas 25 viteve në liri vijnë lahperat nga Prishtina të kulmisur në LVV me seli në Prishtinë - Beograd dhe Athinë, në zemër të Drenicës - Skenderaj ngrehin tre gishtërinj në emër të atit - birit dhe shpirtit të shenjtë. Deri kur do ti tolerojmë këta idiot që fshehën pas petkut partiak dhe politik, Drenica gjithnjë e ka pas tradite për mikun (buk e krip me zemër) për armikun plumb ballit sepse farën e birzumë në Shumadi vetëm plumbi e skuqe”. “Ta provokosh Drenicën gjakun e derdhur nga viti 1389 kjo është antinjerëzore dhe bizare! Kush! Bijtë e kurvave nga Prishtina! Me demagogun dhe gënjeshtarin me të madh të shek. XXI Kurcin”. Po ashtu ka theksuar se “se herën tjetër a po i presim me lule dhe tepih të kuq apo me batore dhe hanxhar”. Gjithashtu ka theksuar se “ata vijnë nga Prishtina me porosi të Beogradit dhe ngrehin tre gishta nuk ka më as tolerancë as hyrje në Drenicë dhe kërkon nga strukturat e komunale të Skenderajt që subjekti politik LVV-në ta shpallin non grata dhe atë zyre me tre apo katër shulikuranta ta mbyllin, dhe kush të dojë nga Drenica le të vejë në Prishtinë apo Beograd të zhvilloj aktivitetet...”.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, rrethanat e konstatuara nga PAZP, sa i përket ankese së lartcekur janë përcaktuese për shqiptimin e dënimit me gjobë ndaj subjektit politik (PDK), pasi që me përdorimin e gjuhës së tillë, ky subjekt ka konsumuar shkeljen nga neni nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mirëpo dënimi me gjobë i shqiptuar nga PZAP, për shkeljen në fjalë është dënim i lartë, për çka kjo gjykatë, ka vendosur për ndryshimin e vendimit të atakua, për arsye se:

Duke i marrë në konsideratë të gjitha rrethanat faktike të konstatuar nga PZAP, dhe rrethanat specifike lidhur me lartësinë e gjobës, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, është diktuar nevoja e ndryshimit të vendimit të atakuar, për shkak se PZAP, gjobën e shqiptuar si në dispozitiv të vendimit e ka mbështetur në të dy ankesat e subjektit politik LVV, ndërsa Gjykata Supreme ka vlerësuar se ankesa A.nr.284/2025 e datës 01.02.2025, është e pa bazuar. Prandaj duke pas parasysh se natyra e shkeljes sipas ankesës A.nr.280/2025 të datës 31.01.2025 dhe ndikimi i



mundshëm i saj në procesin zgjedhor në fjalë, kanë qenë me efekt minimal në cenimin e standardit, të sigurisë dhe Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike. Natyra e shkeljes është e tillë që nuk ka ndikuar në imazhin e përgjithshëm të zgjedhjeve, prandaj gjoba në lartësi prej 8,000 €, vlerësohet si dënim ekuivalent me të gjitha rrethanat e theksuara.

Pretendimet sa i përket faktit se PZAP, nuk e ka arritur të argumentoj përgjegjësin subjektive ndaj subjektit politik PDK, Gjykata Supreme vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar. Në këtë rast PZAP, drejtë ka vendosur kur e ka shpallur përgjegjëse subjektin politik PDK, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se personat që kanë përdorur gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë denigruese, janë mbështetës të subjektit politik PDK, prandaj një vlerësim i tillë që të shpallët përgjegjës ky subjekt politik nga ana e PZAP-së, është i drejtë dhe i ligjshëm.

Në raport me pretendimet se subjekti politik PDK, në mënyrë të vazhdueshme ju ka bërë thirrje mbështetësve të tyre që të përmbahen nga përdorimi i gjuhës fyese, denigruese dhe që ngjallin urrejtje dhe të njëjtit janë ftuar ti respektojnë rregullat zgjedhore, Gjykata Supreme vlerëson se ky veprim i ndërmarr nga ky subjekt politik, është i mirëseardhur dhe i njëjti kontribuon në mbarëvajtjen e drejtë të procesit zgjedhorë, mirëpo i njëjti veprim nuk e liron nga përgjegjësia, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të rregullave zgjedhore dhe me të drejtë PZAP, ka shqiptuar gjobën, të cilën e mbështet edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pjesës refuzuese nga ana e Gjykatës Supreme lidhur me ankesën A.nr.284/2025 të datës 01.02.2025, të ushtruar nga LVV, në PZAP, kjo gjykatë konstaton se PZAP, gabimisht ka vlerësuar se i njëjti postim përmban fjalor i cili bie në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 pika 1.11 të LZP-së, faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës konkretisht dëshmitë e ofruara me ankesë shihet se Rasim Brahim Rexhepi mbështetës i subjektit politik PDK nëpërmes rrjetit social facebook, ka theksuar “Mirëmëngjesi populli i Albin mashtruesit që nuk ja ka pranë e njoft gruaja shtetin e Kosovës tash nuk e ka as të drejtën e votës a ju e keni ngul në krye të Qeveris një kryeministër që nuk ja njeh gruaja e fmija shtetin çka i duhet ktij vendi, vlerësoni vet, dikush e ka jep krejt mundin jetën edhe familjen për këtë shtet e kryeministrit nuk ja njeh gruaja shtetin!”.

Nga deklaratimet e cituara më lartë Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11 të LZP-së. Deklarimet dhe postimi i cituar gjatë fushatës nuk përmbajnë fjalor që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose



provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 120 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 36 paragrafi 2, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr. 39/2025 datë 06.02.2025.

Kryetar i kolegjit,
Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
I AČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ofiashceni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

JYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-39/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNIČA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PLA P PRISTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqijt, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTGYKIM

06.02.2025

Numri i shtojcave:
broj priloga

2

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

A. Hani

10.02.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioa ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

074
12:02

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është afilabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.